REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 121/17
Datë/Datum. 21.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: **KOMUNA E MITROVICES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **642/17/010/521**

Sa i përket tenderit për: **Shenjëzimi HORIZONTAL dhe VERTIKAL në qytetin e Mitrovicës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

RSM COMPANY SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

ÇAGLLAVICE, P.N. PRISHTINE
(Adresa)

PRISHTINE
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

045 977 750
(Numri Telefonit)

N.A.
(Numri i Faks-it)

AGIM KOLA
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
rsm.prishtina@gmail.com
(Adresa elektronike)

21.04.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

RSM Company sh.p.k. Rruga Shqiptarët e Evropës - Shtëmbalë

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate eshte publikuar ne website te KRPP me date: ***07.03.2017.*** *Afati i fundit per dorezim te tenderit (Fizikisht dhe elektronik) ka qene me date:* ***03.04.2017, ne ora: 14:00*** *Hapja e tenderit eshte bere me date:* ***03.04.2017 ne ora: 14:00.*** *Njoftimi per dhenie te kontrates eshte shpallur ne website te E-prokurimit me date:* ***06.04.2017*** *Kriteri per dhenien e kontrates ka qene:* ***Tenderi i pergjegjshem me Çmimin me te ulet***

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po	X			**Jo**	

Procesi I hapjes se tendereve ka shkuar ne rregull, konform rregullave te prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK

lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				**Jo**	

Lidhur me eleminimin tone, jemi njoftuar me ane te njoftimit per tenderuesit te pasuksesshem.
Kemi bere qasje ne dokumentacion, dhe poashtu kemi bere kerkese per rishqyrtim tek AK, me dt. 10.04.2017, kemi bere kerkese per rishqyrim me dt. 10.04.2017, dhe na eshte kthyer pergjigja me dt. 13.04.2017.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti kontraktues ka bërë shkeljen e dispozitave të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Republiken e Kosovës, Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 , dhe Dosjes se Tenderit:

<u>Neni 59- Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi I Tenderëve, Nenpika</u> 4 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshem vetem nëse tenderi në është ne perputhshmeri me te gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.

<u>Neni 60-Kriteret per dhenien e kontrates, Nenpika 1.1</u>
Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontraten publike operatorit ekonomik qe ka dorezuar tenderin e pergjegjshem me çmimin me te ulet.

<u>Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët</u> - Pika 1 -Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni, dhe; Pika 4 - Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.

<u>Neni 68 – Gjendja ekonomike dhe financiare</u> – Nenpika 1.3 kopjet e certifikuara të një ose më shumë bilanceve të gjendjes ose ekstrakteve nga bilancet e gjendjes nëse kërkohet publikimi i bilanceve të tillë të gjendjes në kuadër të ligjit në vendin e themelimit të operatorit ekonomik; ose Nenpika 1.4. kopjet e raporteve financiare dhe raporteve të menaxhimit të certifikuara nga një firmë e njohur e licencuar për kontrollim.

<u>Neni 70-Standardet për Sigurimin e Cilësisë</u>
Po qe se autoriteti kontraktues kërkon dorëzimin e certifikatave të hartuara nga organet e pavarura me të cilat vërtetohet përputhshmëria e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, autoriteti kontraktues do t'u referohet sistemeve për sigurimin e cilësisë që: (i) bazohen në standardet përkatëse Kosovare, Evropiane ose ndërkombëtare dhe (ii) të certifikuara nga organet që kryejnë veprimtaritë e tyre në pajtim me ato standarde për ushtrimin e aktiviteteve të tyre të certifikimit lidhur me aktivitetet e certifikimit.
Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

<u>Neni 59- Ekzaminimi, Vlersimi dhe Krahasimi I Tenderëve, Nenpika 4</u>
Autoriteti Kontraktues ka vepruar ne kundershtim te ketij neni, pasi qe kompania e shpallur fituese Malsija, ne dokumentacionin e saj tenderues nuk ka paraqitur deshmi te mjaftueshme qe tregojne qe i permbush te gjitha kerkesat e parashtruara ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.

<u>Neni 60-Kriteret per dhenien e kontrates-Nenpika 1.1</u>
Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, pasi qe ka shpallur fitues nje kompani e cila nuk ka qene e pergjegjshme, pasi qe ne dosje te tenderit ka paraqitur nje Certifikate te 3M te skaduar ne Mars 2017, ndersa dorezimi i tenderit ka qene me date 03.04.2017.
Poashtu kompania e shpallur fituese ka paraqitur Kopjen e Licences se Auditorit te panoterizuar, sic eshte kerkuar ne dosje te tenderit, pra ka paraqitur vetem kopje te atij

dokumenti.

Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Pika 1 dhe Pika 4

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni, pasi qe fillimisht eshte dashur te kerkoje nje sqarim nga kompania e shpallur fituese, per disa nga cmimet e ofruara, te cilat jane jashte cdo logjike, dhe te cilat nuk perkojne me cmimet e tregut.

Shembull 1 Pozicioni **4.1 - Pragjet rrugore prej gome për ngadalësimin e shpejtësis (policë të shtrir) me dimensione 500(mm) të gjera ,gjatësi 900(mm) dhe lartësi 50 (mm),** kompania e shpallur fituese ka ofertuar me cmim prej 1.80 Euro/m′ (me TVSH), kurse cmimi me i lire i tregut per kete pozicion eshte ne vlere prej 33.00 Euro/m′

Shembull 2 - Pozicioni 6.1 , 6.2, 6.3 – Kompania e shpallur fituese, ne keto pozicione ka ofertuar me cmim prej 2.50 euro/cope, kurse kostoja e furnizimit me e lira e mundshme eshte 19.50 Euro / cope, duke perfshire tabelen, folien, shtyllen, pa perfshire hapjen e gropes dhe betonimin.

Shembull 3 - Pozicioni 6.4 – Kompania fituese per kete pozicion ka ofertuar me cmim prej 2.80 Euro/cope, kurse nje tabele 600x900 mm blehet me cmimin 8.5 euro/cope ne Itali, kurse kostoja e folies(Adezivit) se kualitetit te kerkuar per nje tabele me kete dimension kushton 5.94 euro qe gjithsejt del me cmimin 14.4 euro/cope. Poashtu kesaj kostoje i shtohet edhe shtylla qe kushton 7 euro/3m, qe gjithsej kostoja del 21.40 Euro/cope, pa perfshire hapjen e gropes dhe betonimin.

Shembulli 4 – Pozicioni 6.5 – Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 3.00 Euro/m^2, ndersa kostoja e kesaj tabele eshte : 31.00 Euro, pa perfshire kapriata, gropa dhe betonimi i saj.

Shembulli 5 – Pozicioni 6.8 – Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.10 Euro/cope, qe eshte jashte cdo logjike, pasi qe nje tabele e tille kushton 16.00 Euro pa transport dhe dogane, dhe pa perfshire sherbimin e montimit.

Shembulli 6 – Pozicioni 7.1 – Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.10 Euro/cope, kurse cmimi i furnizimit me i lire i mundshem eshte 33.00 Euro/cope, pa montim, shtylle, grope dhe betonim.

Shembulli 7 – Pozicioni 8.1 – Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.20 Euro/m′, kurse cmimi i furnizimit eshte 18.00 Euro/m′, pa perfshire transportin dhe montimin.

Shembulli 8 - Pozicioni 8.2 – Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.80 Euro/m′, kurse sipas cmimit te tregut, ky produkt kushton 20.00 Euro/m′.

Shembulli 9 - Pozicioni 10.1 – Cmimi i ofruar nga kompania fituese eshte 0.80 Euro/cope, kurse vetem galvanizimi i ketyre shtyllave kushton 2.80 Euro/cope, ndersa komplet nje shtylle antipark arrin nje vlere prej 8.00 Euro/cope.

Pra marre ne teresi, kostoja totale e ketij projekti me sasite e parapara ne dosje te tenderit, arrin mbi 50 % te vleres se ofertes se OE Malsija, e cila me ato cmime ka per qellim demtim te tregut ne fushen e sinjalistikes.

Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni dhe te udhezimit te KRPP-se per rregullat e tendereve jo-normalisht te ulet, pasi qe oferta e OE Malsija, i ploteson te 3 kriteret esenciale per tu shpallur tender jo normalisht i ulet. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues nuk i ka bere fare llogaritjet, dhe ka vepruar ne kundershtim me nenin 61 te LPP, pra eshte dashur te kerkohen sqarime lidhur me cmimet e ofruara nga OE Malsija, ne menyre qe te arsyetohen cmimet abnormale te uleta te ofertuara nga OE Malsija.

Neni 68 - Gjendja ekonomike dhe financiare, Pika 1.3 dhe 1.4

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te ketij neni pasi qe:

Ne dosje te tenderit eshte kerkuar: **a.Auditimi i pasqyrave financiare nga një Compani e licencuar ose nje auditor i licencuar për vitet (2014,2015,2016) - Licenca e Auditorit e Noterizuar**, kurse kompania e shpallur fituese, ka paraqitur Auditimet por nuk ka paraqitur Licencen e Noterizuar te Auditorit, por vetem nje kopje te ketij dokumenti.

Kurse ne kemi paraqitur Auditimet dhe licencat e auditorit te noterizuara ashtu sic eshte kerkuar ne dosje te tenderit.

Neni 70- Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te ketij neni pasi qe ne dosje te tenderit eshte kerkuar:

b.Të bashkangjesë QERTIFIKATË "3M" Ndërkombetare në emër të Companisë (Origjinal ose copje e noterizuar).-

Kurse kompania e shpallur fituese ka paraqitur kete certifikate po me afat te skaduar, ku afatin e skadimit e ka patur ne muajin Mars 2017, kurse dorezimi i tenderit ka qene me date 03.04.2017.

Edhe ne kemi pasur certifikaten paraprake me afat skadimi te njejte, por me kohe kemi bere aplikimin per tu pajisur me Certifikaten e re me afat.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Parashtruesit e kësaj kerkese kane bërë shpenzime të mëdha lidhur me përgatitjen e

Dosjes së Tenderit, vlera e të cilave do të përcaktohet në të ardhmen, për çka pason vlerësimi me shkrim.

9. Propozim

Ofroni, nëse është e mundur propozimin tuaj për hapat e mëtutjeshëm në lidhje me këtë aktivitet të prokurimi:

Parashtruesit e kësaj ankese, i propozojne OSHP-së :

- **që të korrigjojë shkeljet e vërtetuara si më lartë ,të parandalojë dëmtimin e mëtejmë të parashtruesit të ankesës, dhe te merr vendim per anulim te ketij aktiviteti te prokurimit, pasi qe ne baze te sasive te planifikuara, dhe buxhetit te parapare per kryerjen e atyre puneve, nuk perputhet asesi, pasi vetem kostoja e sasive te parapara arrin vleren e 50% mbi oferten e OE Malsija, dhe ky tender duhet te shkoj ne ritenderim dhe te behet rishikimi I sasive ne koordinim me buxhetin e parapare te Komunes se Mitrovices per kete project.**

- **që në emër të preventives dhe eliminimit të parregullsive në zbatim të procedurave ligjore dhe të dispozitave të lartë përmendura të LPP-së, që të pezullojë zbatimin e aktiviteteve të parapara me Kontraten Kontestuese nga Dosja e Tenderit në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.**

Ne si OE, mbesim me shprese qe OSHP-ja, ankesen tone ta vleresoje drejte dhe ti parandaloje padrejtesite dhe humbjet ne aspektin financiar qe na shkaktohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve,*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *Kopje e certifikates se 3M (E skaduar)- OE Malsija*
- *Kopje e licences se Auditorit (E pa noterizuar) – OE Malsija*
- *Kopje e Paramases dhe Parallogarise se kompanise Malsija*

- *Pergjigja e AK-se ne Kerkesen per Rishqyrtim*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*